

VENDIM
Nr. 582, datë 10.9.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 846, DATË 27.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, TË DISA OBJEKTEVE DHE TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË E PRONËS NR. 84, ME EMËRTIM “ISH-REGJIMENTI I KIMISË”, ME VENDNDODHJE NË SHTISH-TUFINË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 846, datë 27.9.2013, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... për t’i përdorur për ngritjen e një vendqëndrimi për strehimin e familjeve të komunitetit rom ...” zëvendësohen me “për t’i përdorur për ngritjen e funksionimit të Qendrës Kombëtare Transitore të Emergjencës ...”.

2. Ngarkohen ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama